



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, me 30.06.2023

SHPLLJE VENDIMI

Drejtur : Njesia Administrative Pojan Bashkia Maliq

Për: Elina Islami (Ropi)
Me adrese: Fshati Zvezde Maliq

Bashkalidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 324 UE dt. 30.05.2023 për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*, pasi dëftesa e komunikimit është kthyer me shënimin : " Larguar ..." dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot ne datë -----
Njesiane Administrative Pojan Bashkia Maliq

(emër, mbiemër, firmë)

Nr. 80 Prot

- Mj-t. Pojan
- STAMP
dt 05.07.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

NR.90200-00751-41-2023 (324 UE) AKTI
Datë 17.05.2023 Regj. Them

Nr.41-2023-1679 (324UE)VENDIMI
Datë 30.05.2023 VENDIMI

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë e përbërë prej:

GJYQTAR: ARTUR PRENGA

Asistuar nga sekretari gjyqësor Guri Sofi, sot më datë 30.05.2023, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore pa praninë e palëve, çështjen me nr. 90200-00751-41-2023 (324 UE) Akti, që i përket:

KËRKUESE Elina Islami (Ropi), e bija Selmani dhe Albanës, e datëlindjes 14.03.1990, banuese në fshatin Zvezdë, Korçë.

OBJEKTI Kërkohet lëshimi i Urdhërit të Ekzekutimit për Vendimin Nr.274, datë 29.01.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

BAZA LIGJORE Neni 510/d, 511 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata mori në shqyrtim çështjen në seancë gjyqësore pa praninë e palëve, në respektim të standarteve të një procesi të rregullt ligjor dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi:

V Ë R E N:

Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me kërkesën me objekt si më sipër.

Gjykata përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj dhe prova të kërkesës, analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështjeje.

Në bazë të Neneve 36/1 dhe 59 të K. Pr. Civile, gjykata pasi shqyrtoi nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil. Në bazë të Neneve 41, 510/d dhe 511/ç të K. Pr. Civile, gjykata është kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkesë si nga pikëpamja lëndore dhe tokësore.

Gjykata, gjithashtu në vështrim të Neneve 71, 72, dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se nuk

ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundështuar dhe nga kërkuesi me anë të ndonjë kërkesë. Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile, gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se:

Pranë kësaj Gjykate është regjistruar edhe çështja civile nr. **90200-02142-41-2015(564Prot)** Akti, date regjistrimi 18.09.2015 që i përket:

KËRKUESE *Elina Islami (Pinderi), e bija e Selman dhe Albana, dtl.1990, banuese në Zvezdë, Korçë, përfaqësuar me prokurë të posaçme Nr.715 rep, Nr.628/1 Kol, datë 26.08.2015 nga avokat Alfred Thomo.*

OBJEKTI *Lëshimi i Urdhërit të Ekzekutimit të vendimit nr.. datë 25.10.2013*

BAZA LIGJORE *Neni 510/d, 511 i Kodit të Procedurës Civile.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin Nr.41-2015-3318 (564 Prot), datë 22.09.2015, ka vendosur:

1. *Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të vendimit nr.274, datë 29.01.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.*
2. *Shpenzimet gjyqësore 200 lekë në ngarkim të kërkueses.*
3. *Vendimi është i formës së prerë dhe me zbatimn e tij ngarkohet Shërbimi Përmbarimor.*

Nga shqyrtimi i akteve rezulton se çështja civile objekt gjykimi është e njëjtë me çështjen civile Nr.41-2015-3318 (564Prot), datë 22.09.2015.

Gjykata e ndodhur në këto rrethana ndërpreu vazhdimin e mëtejshëm të seancës gjyqësore dhe konkludoi në pushimin e gjykimit të çështjes. Marrja e vendimit të pushimit përlligjet me faktin se çështja civile Nr.41-2015-3318 (564Prot), datë 22.09.2015, është me të njëjtat palë, ka të njëjtin shkak dhe të njëjtin objekt me çështjen objekt gjykimi, dhe rezulton të jetë e regjistruar më parë në këtë gjykatë.

Neni 58 i Kodit të Procedurës Civile parashikon shprehimisht se: « Kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë.»

Ndërsa në nenin 299/c të K.Pr.Civile parashikohet se: “Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: c) pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj”.

Në këto kushte çështja civile objekt gjykimi është e njëjtë me çështjen civile Nr.41-2015-3318 (564Prot), datë 22.09.2015, me të njëjtat palë, ka të njëjtin shkak dhe të njëjtin objekt me çështjen objekt gjykimi, dhe rezulton të jetë e regjistruar më parë në këtë gjykatë, në zbatim të nenit 58 dhe 299/c të K.Pr.Civile, i ndryshuar me ligjin nr.38/2017, sjell si pasojë pushimin e gjykimit të çështjes civile.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenect 125, 306 – 310, 58, 299/c të Kodit të Procedurës Civile;

VENDOSI:

1. Pushimin e gjykimit të kërkesës civile.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane, brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoffimit të vendimit të arsyetuar kërkueses Elina Islami (Ropi).

U shpall sot, më datë 30.05.2023, në Korçë.

SEKRETAR/GJYQESOR
Guri Sof

GJYQTAR
ARTUR PRENGA

SHPENZIMET GJYQËSORE
Taksë Regjistrimi 200 lekë
TOTALI 200 lekë